



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE VITI 2022
Ligji 119/2014

| Nr. | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|-----|-----------------|--|-------------------|---|----------------------------------|--------|
| 1 | 12.01.2022 | Kërkohet informacion lidhur me buxhetin për shërbimin e pastrimit, si dhe informacion të detajuar për menaxhimin e mbetjeve. | 20.01.2022 | <p>Lidhur me vendepozitimin e mbetjeve është vetëm 1 vend, në vendin e quajtur Kalbaç, i përcaktuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Pika fundore e vendosur në dispozicion për Bashkinë Klos për sa i përket depozitimit të mbetjeve ndodhet 9 km larg Qafës së Buallit, me koordinata: 430771,011E 4590061,698N (34T).</p> <p>Aktualisht ka zona që nuk mbulohen nga shërbimi i pastrimit në territorin e Bashkisë Klos. Ky shërbim nuk ofrohet në Njësinë Administrative Xibër dhe në disa fshatra të thellë të Bashkisë Klos. Një nga arsyet e mungesës së këtij shërbimi në këto zona është mungesa e infrastrukturës në mënyrë që të mundësohet lëvizja kamionit të pastrimit, pasi rruga në këto zona nuk është shtuar me asfalt. Bashkia Klos shërbimin e pastrimit e mbulon me buxhetin e saj.</p> | Me email | Nuk ka |
| 2 | 18.01.2022 | Kërkohet informacion për familjet e pastreha. | 25.01.2022 | <p>Në bashkinë Klos kemi 117 familje të pastreha që kanë kërkuar ndihmë e janë trajtuar sipas një ndër formave (me bonus qeraje) që parashikon ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”. Lidhur me programin social “Për Subvencionimin e Interesave të Kredisë” në Bashkinë Klos ky program po</p> | Me email | Nuk ka |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

| | | | | | | |
|---|------------|---|------------|--|-----------------|---------------|
| | | | | zbatohet për herë të parë , aktualisht jemi në fazën e dytë të aplikimit. | | |
| 3 | 08.02.2022 | Kërkohet Informacion për dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit , procesverbalit të mbajtur nga bashkia Klos lidhur me Shkollën e Suçit. | 09.02.2022 | Janë vënë në dispozicion dokumentat e kërkuara! | Me email | Nuk ka |
| 4 | 02.03.2022 | Kërkohet vënie dokumentacioni në dispozicion të praktikave të ndjekura për trajtimin e çështjes së Shkollës së Suçit. | 07.03.2022 | Referuar kërkesës tuaj për vënien në dispozicion të projekteve që bashkia Klos ka gati për rindërtimin/rikonstruksion, ju bëjme me dije se deri në financimin e projektit, projekti nuk mund të afishohet. Mbetemi në pritje të hapjes së thirrjes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për të aplikuar. Bashkëlidhur, ju dërgojmë të skanuara praktikat e ndjekura nga Bashkia Klos, për trajtimin e çështjes së shkollës “Haxhi Lata” Suç. | Me email | Nuk ka |
| 5 | 16.03.2022 | Kërkohet informacion, lidhur me aktivitetet kulturore të institucionit për gjatë vitit | 25.03.2022 | Lidhur me aktivitetet kulturore për vitin 2021, Bashkia Klos ka realizuar 9 të tilla, me një buxhet prej 1.182.993 lekë për të gjitha aktivitetet. Aktivitetet bazohen në kalendarin e festave dhe ditëve të rëndësishme kombëtare dhe jo vetëm, si dhe në ditët historike apo festive të zonës. Në disa prej aktiviteteve është bërë e mundur përfshirja e të rinjve për t'i angazhuar sa më shumë. | Me email | Nuk ka |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

| | | | | | | |
|---|------------|---|------------|---|--|---------------|
| 6 | 11.05.2022 | Kërkohej informacion mbi Këshillat Vendore të Sigurisë Publike, për krijimin e tyre dhe zhvillimin e tij deri më sot. | 16.05.2022 | Edhe Bashkia Klos ka ngritur Këshillin Vendorë të Sigurisë Publike , si një strukturë ndihmëse me funksione këshillimore që ka si qëllim parësor identifikimin e problematike të sigurisë vendore dhe sjelljen e tyre në Këshillin Bashkiak, për të marrë më pas hapat e nevojshëm për adresimin e tyre. KVSP Klos është përditësuar për herë të fundit me vendim nr.6 datë 27/01/2021, “Për rishikimin e VKB nr.44 datë 23.05.2019 , për përditësimin e Këshillit Vendorë për Sigurinë Publike të ngritur në Bashkinë tonë”. Gjithashtu për KVSP Klos është hartuar një rregullore funksionimi e cila është miratuar në Këshillin Bashkiak. KVSP Klos ka hartuar e miratuar edhe një Plan Veprimi 2- vjeçar me datë 30/ 06/2021 për periudhën Qershor 2021- Qershor 2023. Së fundmi nga data e përditësimit me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.6 datë 27/01/2021 të KVSP Klos, janë realizuar 4 mbledhje/takime, me anëtarë të këshillit. Dy takime janë zhvilluar në Bashkinë Klos dhe takimi i tretë është realizuar në Bashkinë Elbasan, me pjesëmarrjen e anëtarëve të KVSP Klos e KVSP Mat, si dhe takimi i fundit është zhvilluar në Bashkinë Mat, për të cilat bashkëlidhur do të gjeni dokumentat (processverbal e agjenda). | Me email/ Postë zyrtare | Nuk ka |
| 7 | 10.06.2022 | Kërkohej informacion lidhur me ekipet sportive, OJQ-ve sportive të regjistruara momentalisht në Bashkinë Klos. | 20.06.2022 | Ne bashkinë Klos kemi te regjistruar vetem ekipin zyrtar te futbollit KF Klosi, i cili bën pjese ne kategorine II, grupi A në Federatën Shqiptare të Futbollit. | Me email | Nuk ka |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

| | | | | | | |
|----|------------|--|------------|---|-------------------------|---------------|
| 8 | 30.06.2022 | Kërkohej informacion lidhur me punonjës të institucionit të cilët kanë lidhje me dekriminalizimin. | 06.07.2022 | Lidhur me pikat e kërkesës tuaj ju informojmë se për periudhën për të cilën ju interesoheni, 01.10.2019 deri më Qershor 2022 nuk kemi asnjë rast largimi, apo në proces hetimor, dënues apo që kanë refuzuar plotësimin e formularit për shkak të dekriminalizimit, për punonjës të Bashkisë Klos në pozicionet drejtuese. Ndërsa lidhur me listën e Këshilltarëve Bashkiak që kanë refuzuar plotësimin e formularit të Dekriminalizimit, nuk kemi asnjë rast për sa ju kërkoni, për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022. | Me email | Nuk ka |
| 9 | 30.06.2022 | Kërkohej informacion lidhur me mbeturinat në fshatrat Pleshë dhe Cerujë, nga pamjet e publikuara te TV Mati. | 12.07.2022 | Lidhur me problematikën e mbetjeve përgjatë rrugës së fshatit Pleshë dhe Cerujë ju bëjmë me dije se kanë qenë persona të paidentifikuar të cilët kanë shkaktuar problematika me koshat e mbetjeve të vëna për gjatë kësaj rruge konkretisht një kontenier në lagjen Dibra është vjedhur, fshati Pleshë dhe një kontenier pranë Q.SH.Cerujë largohet herë pas here nga vendi i caktuar dhe hidhet në një përrua aty pranë. Kjo problematikë është zgjidhur nga bashkia Klos dhe po tregohet vëmendje maksimale për përmirësimin e cilësisë së pastrimit në përgjithësi. | Me postë zyrtare | Nuk ka |
| 10 | 07.07.2022 | Kërkohej informacion lidhur me shërbimin e zjarrfikës | 15.07.2022 | Bashkia Klos ka hartuar dhe miratuar “ Planin e masave për parandalimin, përballimin e situatave emergjente nga zjarret në pyje e kullota, shtëpi banimi, biznese private për vitin 2022. Bashkia Klos disponon një automjet zjarrfikës, pompa uji shpine, kostume pune, vegla të thjeshta pune si lopata, kazma etj, që shërbejnë për të neutralizuar zjarret në terrenet malore. Njësitë vendore i kanë buxhetet e përcaktuara dhe të limituara, sakaq mbetet gjithmonë nevoja për ndërhyrje nga pushteti qëndror dhe ministritë e linjës për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet për ekipin zjarrfikës të bashkive. Për shkak të terrenit kryesisht malor-kodrinor të | Me email | Nuk ka |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

| | | | | | | |
|----|------------|--|------------|---|-----------------|--------|
| | | | | Bashkisë Klos, mbetet si nevojë sigurimi i një automjeti tip foristradë për në zonat e thella aty ku nuk është e mundur kalimi i zjarrfikëses | | |
| 11 | 26.07.2022 | Kërkohet informacion lidhur me zbatimin e politikave për rininë. | 29.07.2022 | Në buxhet nuk ka një zë specifik për rininë, në rast nevojë buxheti i paracaktuar për sektorin ku pjesë e së cilit është edhe struktura e Rinisë , mund të përdoret. Të punësuar të grupmoshës 18-29 vjeç zënë rreth 35,7% të punësuarëve. Është krijuar dhe e konsoliduar si strukturë e mirëfilltë rinore (Këshilli Rinor). Kemi bashkëpunuar me një projekt të ambasadës amerikane Vazhdimisht Bashkia Klos ka në fokus rininë ku përmes aktiviteteve të ndryshme përfshin dhe bën pjesë edhe të rinjtë. Një projekt për rininë ishte aktiviteti i zhvilluar nga Fondacionit “Friedrich Ebert” me mbështjen e Kryetarit të Bashkisë Z. Ilmi Hoxha. Të rinjtë e Klosit u trajnuan për dy ditë rresht duke zhvilluar projektin; Loja simuluese mbi politikën vendore: “Pa rini nuk ka shtet”. Aktiviteti konsistoi në zhvillimin e trajnimit dy ditor ku; në ditën e parë të rinjtë mësuan bazat e politikës vendore si dhe ndoqën nga afër mbledhjen e këshillit bashkiak, për të parë funksionimin e saj. E ndërsa në ditën e dytë vetë të rinjtë zhvilluan një mbledhje këshilli bashkiak, duke u vënë në rolin e këshilltarëve. Mbledhjes së të rinjve ju bashkua edhe Kryetari i Bashkisë i cili mirëpriti projekt-propozimet dhe pyetje nga të rinjtë. | Me email | Nuk ka |
| 12 | 26.09.2022 | Kërkohet informacion për financa të bashkise, shërbimive publike, e shumë informacione të tjera rreth Bashkisë Klos. | 26.09.2022 | Janë vënë në dispozicion dokumentat e kërkuara! | Me email | Nuk ka |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

| | | | | | | |
|----|------------|---|------------|--|-------------------------------------|--------|
| 13 | 27.09.2022 | Kërkohej informacion për përgatitjen e procesit zgjedhor për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2023 | 06.10.2022 | Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë se: Numri aktual i banorëve në Bashkinë Klos është 20,057; numri i banorëve mbi moshën 18 vjeç është 15,250; numri i personave të verbër është 87; numri i personave me aftësi të kufizuar është 622 e ndarë si më poshtë:Paraplegjikë 34;Invalidë pune 237;Persona të paaftë 351.Numri i personave me asistencë sociale është 1,506. Në bashkinë Klos jetojnë 139 banorë (31familje)të komunitetit Egjiptjan.Numri total i punonjësve është 246, nga të cilët 30 janë me statusin e nëpunësit civil, 5 punonjës janë në proces marrje statusi civil dhe 118 punonjës janë me kontratë. Gjithashtu janë vënë në dispozicion kontaktet zyrtarepër personat e kërkuar si dhe të Bashkisë Klos. | - Me email -Me postë zyrtare | Nuk ka |
| 14 | 12.10.2022 | Kërkohej informacion në lidhje me detyrimet e Bashkisë Klos ndaj OSHEE-së. | 20.10.2022 | Bashkia Klos ka detyrime të prapambetura ndaj OSHEE-së të akumuluar nga faturat e pompave vaditëse.Për këto detyrime jemi në proces gjygjësor me FSHU për mbifaturim.Pas përfundimit të procesit gjygjësor nëse bashkia mbetet debitor do të bëhet plani për shkyejen e detyrimeve. | - Me email | Nuk ka |